

Emri i Shkollës: _____

Firma: _____

Informacion mbi huazimin e librave shkollorë

I nderuar _____,

E nderuar _____,

Të nderuar nxënës dhe nxënëse,

për vitin e ardhshëm shkollor fëmija juaj ka nevojë për libra shkollorë të printuar. Materialet dixhitale¹ do të përdoren po ashtu në shkolla. Prindërit/kujdestarët janë përgjegjës për sigurimin e mjeteve mesimore.

Detyrat përgatiten pas mësimit². Përgatitja për mësim bëhet me këto materiale ose nëpërmjet teksteve të ndryshme të krijuara vetë.

Prindërit/kujdestarët dhe nxënësit në moshë madhore duhet t'i blejnë librat dhe materialet dixhitale për mësim. Këto libra ju pëkasin juve dhe mund të përdoren edhe më vonë.

Në Sachsen-Anhalt ekziston edhe mundësia e huazimit të librave shkollorë. Kjo do të thotë që prindërit/kujdestarët përjashtohen pjesërisht nga kostot e blerjes. Procesi i huamarrjes është i pavarur nga të ardhurat dhe librat mund të huazohen për një shumë të caktuar parash.

Të ardhurat nga huazimi shkojnë tek shkolla, e cila mund t'i përdorë ato për të zëvendësuar librat e dëmtuar. Shkollat mund t'i përdorë këto paratë për të blerë libra të rinj po ashtu. Ky proces është i rregulluar me ligj:

- Urdhëresa për lehtësimin nga kostoja e materialit miratuar me 17. 4. 2013 (GVBl. LSA S. 174) në versionin e saj aktual.
- Dekreti i materialeve mësimore të MK të 18 prillit 2013 (SVBl. LSA f. 95), ndryshuar për herë të fundit nga RdErl. më 11 maj 2015 (SVBl. LSA f. 69), në versionin e vlefshëm aktualisht.

Për çdo libër të marrë hua paguhet një shumë e caktuar parash. Huamarrja e një libri apo materialeve dixhitale të mësimit kushtin 3 euro për çdo vit shkollor. Tarifa është e reduktuar për disa prindër/kujdestarë/nxënës në moshë madhore.

Grupet e mëposhtme paguajnë 1 Euro për libër apo vit shkollor:

- Fëmijë dhe adoleshentë që jetojnë në shtëpi komunitare ose në grupe banesash (ndihmë për arsimim nga zyra e mirëqenies së të rinjve)
- Prindërit/kujdestarët ose vetë nxënësit marrin përfitim papunësie II, Hartz IV ose përkrahje shoqërore për fëmijë.
- Prindërit/kujdestarët ose vetë nxënësit marrin mbështetje të vazhdueshme për jetesën e tyre (ndihmë sociale)
- Prindërit/kujdestarët ose vetë nxënësit marrin përfitime sipas Ligjit për Përfitimet e Azilkërkuësve

Tarifa ulet gjithashtu për familjet me disa fëmijë.

- 2 euro për libër shkollor dhe vit shkollor nga fëmija i 3-të në moshë shkollorë
- 1 euro për libër shkollor dhe vit shkollor nga fëmija i 5-të në moshës shkollorë

Prindërit/kujdestarët dhe nxënësit në moshë madhore duhet të paraqesin dëshminë e së drejtës për të përfituar tarifa të reduktuara dhe të dhëna të tjera personale duke plotësuar formularin bashkangjitur (Shtojca 2b). Formulari dhe lista e porosive më pas i dorëzohet shkollës në një kohë të caktuar.

Në rast të shkeljeve me dijeni të rregulloreve të tarifave të reduktuara, mund të ngrihen kallëzime penale.

Tarifat paguhen direkt në shkollë. Këto para së bashku me fondet e vëna në dispozicion nga shteti i Sachsen-Anhalt përdoren për të blerë materiale të nevojshme mësimore (libra shkollorë (DA) ose materiale mësimore dixhitale).

¹ Mjetet dixhital mësimi është edhe një E-book

² Me libër shkollor nënkuptohet gjithmonë dhe materialet dixhitale të të nxënës.